



## BURSA STUDIMI NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS VITI AKADEMIK 2024-2025

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh dhe zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Programin e Shkëmbimit Akademik Fulbright, nënshkruar më 25 shtator 2019, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës pranon aplikime për vitin akademik 2024- 2025 për Studentë të Huaj, të cilët janë të interesuar të ndjekin studime në nivelin Master në Shtetet e Bashkuara në fushat e studimit: STEM, Bujqësi dhe Shkenca Jetësore, Shkencat e Kafshëve të Egra dhe Peshkimit, Shkenca Pyjore, Turizmi, Shkenca e Inxhinierisë së Mjedisit, Inxhinieri, Bio-Kimi.

### Kërkesat për Aplikimet:

- Aplikantët duhet të jenë qytetarë të Republikës së Shqipërisë;
- Duhet të kenë të paktën një diplomë të nivelit Bachelor nga një program studimi me kohë të plotë katër vjeçar (ose diplomë të programeve tre + një ose tre + dy, sipas sistemit të Bolonjës);
- Duhet të kenë të paktën dy vjet përvojë profesionale pune në fushën e studimit dhe të shfaqin aftësi udhëheqëse;
- Duhet të kenë një nivel të mirë të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar (ekuivalente të nivelit B2; rezultatet e provimit të TOEFL nuk janë të detyrueshme në momentin e aplikimit.);
- Duhet të kualifikohen për të marrë vizë J-1;
- Duhet të kenë rekorde të mira shëndetësore.

### Procedura e Aplikimit:

Të gjithë aplikantët e interesuar duhet të plotësojnë online formularin Fulbright për Studentë të Huaj. Klikoni <https://apply.iie.org/ffsp2024/>, për formën e aplikimit online, krijoni një llogari, dhe më pas hyni në llogarinë tuaj për të filluar aplikimin. Dërgoni aplikimin e plotë në formë elektronike dhe kopjet e skanuara të të gjithë dokumentave të kërkuara jo më vonë se data 15 korrik 2023. Të gjitha dokumentat e kërkuara duhet të dërgohen online në mënyrë që aplikimi të merret në shqyrtim.

### Aplikimi i plotë përfshin:

- Formularin e aplikimit (të gjeneruar nga sistemi Embark duke përfshirë edhe dokumentat bashkëngjitur në sistem);
- Kopje të përkthyer dhe të noterizuara të diplomave dhe certifikatave të notave nga të gjitha institucionet akademike ku keni studiuar;
- Tre letra reference;
- CV të detajuar;
- Letër nga punëdhënësi që konfirmon punësimin;
- Kopje të faqes biografike të pasaportës;
- Certifikata të tjera (që lidhen me fushën e studimit).

Bursa e programit Fulbright ofron tarifën e shkollimit dhe taksat e universitetit, pagesë mujore për jetesë, libra dhe mjete shkollore, financimi të pjesshëm për kompjuter, udhëtim vajtje ardhje në institucionin pritës (dhe në programin e gjuhës angleze nëse bursisti duhet të marrë pjesë) dhe udhëtimin në Washington DC për një seminar. Fonde të tjera shtesë vihen në dispozicion për aktivitete profesionale si udhëtime apo pjesëmarrje në konferenca. Bursa e programit Fulbright nuk rinovohet.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni adresës në ueb-site:

<https://al.usembassy.gov/fulbright-student-program-2024-2025/>

<https://al.usembassy.gov/sq/programi-fulbright-per-studente-te-huaj-2024-2025/>

Ose kontaktoni: Zyra e Marrëdhënieve me Publikun, Ambasada Amerikane, Tiranë me email: [CultureandEducationTirana@state.gov](mailto:CultureandEducationTirana@state.gov)

**Kujdes:** Aplikimet që do të dërgohen pas datës 15 korrik 2023 dhe aplikimet që do të dërgohen si Google Docs ose nëpërmjet WeTransfer nuk do të merren në shqyrtim.